



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ KOLIN GJOKA”LEZHË

Nr. 386 prot.

Data 04.09.2024

Lënda: Njoftim për vënd të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Përkrijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla Profesionale “Kolin Gjoka”, ju njofton krijimin e vendëve të lira të punës për pozicionet:

-Mësimdhënës të formimit teorik dhe praktik , drejtimi Shërbime Sociale dhe Shëndetësore ,me kohe të pjesshme. (12orë/jave). 2(dy) persona.

- Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shendetesore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës se prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit;

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperience pune në fushën,në te cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdore teknologjine e informacionit;

1. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit,e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë të përfshijë:

- Letër motivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin(CV-në);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ KOLIN GJOKA”LEZHË

- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm.
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 13.09.2024

DREJTORI

Bardh DEDGJONAJ

